



In medias res

Nga ndryshimet në planifikim deri te reforma kurrikulare

“Ne kemi hyrë në betejë....Për tridhjetë vjetët e fundit jemi përpjekur që të rrezikojmë më shumë për të vendosur rrishtë dhe politikën më të reja në vendin e duhur. Filluam në mënyrë naive në vitet e '60 (të shekullit të kaluar: vërejtja e HH)) duke derdhur thasë me para për projekte të kurrikulit kombëtar, shkollat me plan të hapur, mësimdhënie individuale; e tjera kësisoj. Mendohej, por nuk u bë ndonjë plan nga i cili do të dilte diçka.

Ne faktikisht nuk e kemi marrë veten ende nga zhgënjimi i thellë që përjetuam kur shpresat tona na dolën të ishin aq larg realitetit të zbatimit. Dhe vërtetë termi zbatim as nuk përdorej në vitet e '60, madje as na shkonte mendja se mund të ishte problem.

Ajo botë e shpresave të pafajshme u shemb me furi rreth viteve të 70, kur dolën në sipërfaqe studimet e para të zbatimit

Majkël Fullan

Vallë, mos jemi duke bërë tani ne në Kosovë po këtë gabim, por pas gjashtë dekadash dhe në kohën postmoderne, në shekullin e XXI, në kohën kur këtë nuk guxojmë ta bëjmë. Nga viti 2001 deri në vitin 2005 thasë parash u derdhen për të hartuar Kornizën e Kurrikulit të Ri të Kosovës, e cila në atë kohë u quajt “Libër i Bardhë”, bile-bile u shpallë edhe dokumenti më i mirë i hartuar në rajon. Kjo nuk ishte larg të vërtetesës. Vërtet kishim të bënim me një dokument të vlefshëm, zbatimin korrekt i të cilit do të prodhonte ndryshime të rëndësishme dhe të thella në sistemin e arsimit parauniversitar.

Por si në vitet e '60, në Kosovë harrua termi zbatim. Askush nuk mendoj seriozisht të hartojë një plan kreativ të zbatimit të kësaj Kornize kurrikulare. Bile-bile, u harrua edhe procesi i miratimit të saj. Edhe pse u organizua një Konferencë e madhe ndërkombejtare edhe pse u thanë shumë fjalë lavdie për atë dokument, ky dokument asnjë herë nuk u bë dokument zyrtar i Kosovës.

Duke e mos e përfillë këtë dokument, duke e anashkaluar totalisht dhe duke e harruar ekzistimin e tij dhe shpenzimet e mëdha që bënë për hartimin e këtij, turr e vrap filloi reforma e kurrikulave lëndor për të cilit sërish u harxhuan thasë parash. Përsëri u harrua plani për zbatimin e kurrikulave lëndor. Ndodhi ajo që duhet të ndodhte. Kurrikulat lëndore ishin të dobëta, me mangësi të shumta me një koncentrim të madh të dijeve deklarative dhe memorizuese. Ndryshime terminologjike siç ishin kategori dhe nënkategori vështirë se kuptoheshin, standardet e përmbajtës dhe të arritjeve nuk ishin arritur të përcaktoheshin si duhej, sepse në përpilimin e tyre nuk kishin marrë pjesë ekspertët vendor, nuk ishte bërë pilotimi i tyre. U harrua sërish plani i zbatimit, procesi i monitorimit dhe i vlerësimit të zbatimit të tyre. Në terren diskutimi publik ishte formal dhe ai zhvillohej nëpërmjet takimeve informative, nga të cilat nuk përfitonin mësimdhënësit. Agjentët tjerë të ndryshimit siç ishin prindërit, nxënësit nuk u konsultuan. Hartuesit e kurrikulave (një pjesë e mirë e tyre duke e pare leverdinë e madhe financiare nga tekstet, paralelisht me hartimin e kurrikulave i hartuan edhe tekstet që po ashtu si kurrikulat nuk dolën ashtu siç u mendua) ishin përzgjedhë pa kritere. Pa kaluar as dy vite ndodhi zhgënjimi i madh. U pa se ndryshimet kurrikulare nuk ishin prodhuar at që pritej, andaj u vendos që sërish të fillon vallja e re. Tani ka filluar reforma kurrikulare e re. Si do të rrjedhe kjo, nuk dihet ende, por për atë se si duhet të bërë kjo do të shkruajmë në vazhdim

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit maj në kuadër të MKLSH janë mbajtur seminari i V dhe i VI seminare për 120 mësimdhënës, të cilët janë duke vijuar trajnimin në 4 qendra të Kosovës: në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Pejë. Po ashtu gjatë muajit maj është bërë dhe monitorimi i dytë për të gjithë mësimdhënësit.

Analiza e orëve të monitoruara është bërë me 29 maj dhe nga raportet e trajnerëve shihet se mësimdhënësit i kanë përvetësuar shumë mirë teknikat dhe strategjitë e programit të MKLSH-së. Në fund pjesëmarrësit janë informuar se në qershor do të mbahet seminari i VII dhe I fundit si dhe do të bëhet certifikimi i mësimdhënësve.

Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës

■ Në kuadër të projektit për Monitorim të strukturave komunale të Arsimit, gjatë muaji maj nuk ka pasur ndonjë aktivitet të veçantë, janë duke u finalizuar intervistat dhe shumë shpejt pritet përmbledhje e të gjitha të dhënave dhe hartimi i raportit.

KOSOVISION Contest

■ Projekti KOSOVISION CONTEST po vazhdon me aktivitetet e parapara me projekt. Këtë muaj të gjitha klasat pjesëmarrëse në fazën e dytë të projektit kanë përfunduar edhe punën e tyre nëpër shkolla. Pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës, ekipi nga Zvicra ka bërë edhe vlerësimin e tyre me

ç'rast nga 87 klasa pjesëmarrëse ka zgjedhur 22 klasa fituese të raundit të dytë.

Emrat fituese apo shpallja e fitueseve do të bëhet më 5 qershor në Pallatin e Rinisë ku edhe do të bëhet organizimi i ndarjes së shpërblimeve për këtë vit. Të ftuar do të jenë rreth 600 pjesëmarrës.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Komisioni Evropian, janë zhvilluar këto aktivitete:

- Certifikatat e përgatitura i janë dhënë të gjithë pjesëmarrësve që kanë ndjekur trajnimin.
- Monitoruesit e jashtëm kanë dorëzuar të dhënat e monitorimit të dytë.
- Raporti i monitorimit të dytë në baza regjionale është bërë dhe tani jemi në përgatitje të raportit qendror i cili edhe do të përkthehet në gjuhë angleze dhe serbe, do të publikohet dhe do të diskutohet në publik.

■ Në kuadër të këtij projekti, po ashtu ka filluar edhe implementimi i projekteve shkollore pasi që janë vënë kriteret për këto projekte dhe pasi që shkollat kanë dhënë idetë se çfarë do të punojnë. Deri në mesin e muajit të ardhshëm, ne presim që 30 shkollat e synuara të dalin me raporte rreth implementimit të projekteve të tyre nëpër shkolla.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Ka përfunduar viti i parë i projektit 'Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim'.

Me këtë rast është hartuar raporti për vitin e parë dhe i është dërguar personit përgjegjës në Komisionin Evropian.

■ Të gjitha shtetet pjesëmarrëse në projekt i kanë përfunduar raportet "Hulumtimet Kombëtare" në kuadër të komponentës 2 të Projektit. Ekipi i ekspertëve është duke punuar në hartimin e një sintheze të këtyre raporteve.

■ Më 4 korrik do të mbahet një punëtori rajonale për ta rishikuar sinthezën e këtyre raporteve dhe për të nxjerrë disa rekomandime. Punëtorja do të mbahet në Kosovë dhe do të marrin pjesë nga 3 përfaqësues të shteteve partnere në projekt.

Access Microscholarship Program

■ Orët e Access janë në përfundim e sipër, siç është edhe projekti dy vjeçar që pati për qëllim mësimin e gjuhës angleze ku pjesëmarrës të kursit ishin nxënës të shkollës së mesme të etnive të ndryshme. Me rastin e përfundimit të kursit nxënësve që e kanë vijuar me rregull këtë kurs do tu shpërndahen certifikata pjesëmarrjeje. Certifikatat do ti shpërndajë Ambasadori Amerikan në Prishtinë, Christopher Dell. Pas shpërndarjes së certifikatave fëmijët së bashku me prindërit dhe mësimdhënësin e tyre Robert Meszaros do të vazhdojnë me një koktej rasti në restorantin Odyssey Bistro Bar.

Aktiviteti përmbyllës i këtij programi do të jetë aktiviteti social që do të mbahet në

Paintball Prishtina, ku fëmijët do të kenë rast ta kalojnë një ditë së bashku. Në këtë aktivitet do të ftohen edhe nxënësit e grupit Access të Prizrenit.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Me datën 27 maj 2010 u lansua ky projekt. Të pranishmit në këtë ngjarje treguan për qëllimet dhe objektivat e këtij projekti.

Ministri i Arsimit, z. Enver Hoxhaj tha se ky projekt në vlerë prej 3 milion eurosh, financim i Komisionit Evropian, është një mbështetje për sistemin e arsimit si dhe për transformimin e asaj që është e vjetër, me qëllim që ti plotësojmë kërkesat e tregut të Republikës së Kosovës dhe të tregut global të shekullit 21.



Ndërsa Kjartan Bjornsson, nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë u shpreh se edukimi është dhe

mbetet prioritet i Bashkimi Evropian në Kosovë. Projekti, "Qasja Tërësektoriale në Arsim" është i një rëndësie të veçantë për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për shkak se kësaj do të mbështesim qëllimin tonë të përbashkët për përmirësimin e menaxhimit të sektorit të arsimit në Kosovë duke prezantuar dhe zhvilluar reforma përmes një qasje të re. KE, do të vazhdojë të mbështesë në vazhdimësi projektet e të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë, edukimin e brezave të rinj të cilët do të jenë të aftë të përmbushin kërkesat e tregut e Evropian dhe atë të Kosovës.

Projektin e prezantoi Eric Woods, udhëheqës i ekipit për projektin "Qasja Tërësektoriale në Arsim".

Projekti përbëhet nga tri komponentë të cilat do të ndryshojnë thellësisht sistemin tonë arsimorë. Së pari ofron një plan veprues dhe strategjik të hartimit të politikave dhe implementimit të tyre në sistemin tonë arsimor. Së dyti ofron një mbështetje për implementim të Kurrikulumit të Kosovës , dhe së treti, synon që të ofrojë një profil të kompetencave të mësimitdhënësve, një katalog të trajnimeve të mësimitdhënësve dhe zhvillimin e kapaciteteve e të politikave të trajnimit të tyre.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të DKA -ve, OJQ -së dhe mësimitdhënës

Koncepti i qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë

- Gjatë muajit maj, ekipi nga KEC dhe UP, ka punuar në përgatitjen e një raporti të hulumtimit të shpejtë, me qëllim të publikimit të tij. Pritet që ky raport të publikohet deri në fund të muajit qershor.

Projekti i përbashkët i historisë së Evropës Juglindore (JHP)

- Në kuadër të këtij projekti, gjatë muajit maj, janë zhvilluar edhe disa aktivitete që kishin për qëllim përhapjen e idesë së shfrytëzimit të burimeve alternative në mësimitdhënien e lëndës së historisë.

Përgatiti: Petrit Tahiri